REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. _____Prot., Tiranë, më ___.__.2026

V E N D I M

Nr.28, datë 06.11.2026

PËR
MIRATIMIN PËR KËSHILLIM PUBLIK TË PROJEKTRREGULLORES "PËR TREGUESIT E CILËSISË SË SHËRBIMIT"

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	**Gentian Sala**	**Kryetar**
Znj.	**Edlira Dvorani**	**Anëtar**
Z.	**Armer Juka**	**Anëtar**
Z.	**Bleron Dokle**	**Anëtar**
Znj.	**Diana Dervishi**	**Anëtar**

dhe sekretare znj. Dania Nallbani, në mbledhjen e datës 06 nëntor 2026, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike" dhe Rregullores së Brendshme për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) miratuar me vendimin nr.11, datë 31.3.2026, të Këshillit Drejtues të AKEP me propozim të Drejtorisë së Administrimit dhe Menaxhimit të Burimeve të Fundme, shqyrtoi çështjen me objekt:

- Miratimin për këshillim publik të projektrregullores "Për treguesit e cilësisë së shërbimit"

BAZA LIGJORE:

1. Neni 143 i ligjit nr. 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë".
2. Rregullore "Për procedurat e njoftimit dhe këshillimit publik", miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 21, datë 07.12.2021.

K Ë SH I LL I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Dokumenti për miratim për këshillim publik të projektrregullores "Për treguesit e cilësisë së shërbimit";
2. Relacioni shoqërues i projektvendimit;
3. Projektvendimi i arsyetuar,

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Referuar nenit 143 të ligjit nr. 54/2024, AKEP përcakton parametrat e cilësisë së shërbimit, duke përfshirë parametrat përkatës për përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara, metodat e zbatueshme të matjes, përmbajtjen dhe formatin e publikimit të informacionit, si dhe mekanizmat e certifikimit të cilësisë, bazuar në praktikat më të mira evropiane dhe standardet kombëtare dhe ndërkombëtare".
2. Në zbatim të nenit 143 të ligjit nr. 54/2024, AKEP, ka përgatitur dokumentin "Për treguesit e Cilësisë së Shërbimit", i cili do të jetë objekt i këshillimit publik me palët e interesuara. Projektrregullorja, përcakton metodologjinë e matjes së treguesve të cilësisë së shërbimeve të komunikimeve ndërpersonale, të shërbimeve të aksesit në internet, të performancës së rrjeteve publike të lëvizshme dhe të shërbimeve të kujdesit ndaj përdoruesve fundorë, si dhe procedurat për monitorimin, verifikimin, raportimin dhe publikimin e tyre. Njëkohësisht, projektrregullorja përcakton detyrimet e sipërmarrësve për matjen, administrimin dhe raportimin e treguesve të cilësisë së shërbimit, si dhe kompetencat e AKEP-it për mbikëqyrjen dhe kontrollin e zbatimit të këtyre detyrimeve.
3. Dokumenti për këshillim publik, projektrregullorja *"*Për treguesit e cilësisë së shërbimit", nga pikëpamja e ligjshmërisë është në përputhje me përcaktimet ligjore të nenit 143 dhe rregullimet për internetin e hapur të ligjit nr. 54/2024. Po ashtu treguesit e cilësisë së shërbimit dhe metodologjitë e matjes së tyre janë ndërtuar bazuar mbi specifikimet teknike të ETSI dhe 3GPP, rekomandimet e ITU-së, dokumentet teknike të IETF-së dhe udhëzimet e BEREC, duke garantuar përputhshmërinë me standardet e zbatuara nga autoritetet rregullatore të vendeve të Bashkimit Evropian.
4. Bazuar në nenet 44 dhe 45 të ligjit nr. 54/2024 dhe Rregullores "Për procedurat e njoftimit dhe këshillimit publik", miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 21, datë 7.12.2021, dokumenti i miratuar nëpërmjet këtij vendimi do të nxirret për këshillim publik, me qëllim marrjen e mendimit të palëve të interesuara.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 14, dhe pikën 1 të nenit 15 të ligjit nr. 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Të miratojë për këshillim publik projektrregulloren “Për treguesit e cilësisë së shërbimit”.
2. Procedura e këshillimit publik do të kryhet për një periudhë 30 ditore nga data e publikimit të dokumentit sipas pikës 3 të këtij vendimi.
3. Ky Vendim dhe Dokumenti për këshillim publik: projektrregullore “Për treguesit e cilësisë së shërbimit”, të publikohen në faqen e internetit www.akep.al.
4. Ngarkohet administrata e AKEP për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Gentian Sala	**Edlira Dvorani**	**Armer Juka**	**Bleron Dokle**	**Diana Dervishi**